

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR MBYLLJEN E SHOQËRIVE TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR NË
LIKUIDIM”

I. QËLLIMI DHE OBJEKTI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN

Projektligji “Për mbylljen e shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim” ka për qëllim rregullimin e një procedure të posaçme ligjore për përfundimin, mbylljen dhe çregjistrimin përfundimtar të shoqërive tregtare me kapital shtetëror që ndodhen prej vitesh në proces likuidimi, si dhe përcaktimin e mekanizmit për trajtimin, administrimin dhe kalimin e aseteve dhe detyrimeve të tyre.

Qëllimi themelor i këtij projektligji është krijimi i një zgjidhjeje ligjore të qëndrueshme për adresimin e problematikave të akumuluarra ndër vite nga proceset e zgjatura të likuidimit të shoqërive tregtare shtetërore, duke krijuar vështirësi të theksuara në administrimin e detyrimeve, pasurive dhe në ushtrimin e marrëdhënieve juridike të tyre.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet përfundimi përfundimtar juridik, financiar dhe administrativ i shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim; transferimi i të drejtave dhe detyrimeve të tyre te një shoqëri shtetërore pasuese; sigurimi i vazhdimësisë juridike në marrëdhëniet me kreditorët dhe palët e treta, krijimi i kushteve për një administrim më efikas dhe të centralizuar të aseteve dhe pjesëmarrjeve shtetërore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në programin analitik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit apo në programin analitik të akteve normative. Megjithatë, nisma ligjore paraqitet si e domosdoshme për përmbylljen efektive të shoqërive tregtare shtetërore në proces likuidimi, si dhe për administrimin të detyrimeve dhe aseteve.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Një pjesë e shoqërive tregtare shtetërore vijojnë të qëndrojnë për periudha të gjata në proces likuidimi, pa u realizuar mbyllja përfundimtare e tyre. Projektligji synon të adresojë këto problematika duke parashikuar transferimin e aseteve dhe detyrimeve të shoqërive tregtare

shtetërore në proces likuidimi të një shoqëri e vetme tregtare shtetërore, duke krijuar kushtet për një administrim të centralizuar të pasurive dhe pjesëmarrjeve shtetërore.

Zbatimi i projektligjit pritet të kontribuojë në përmirësimin e administrimit të pasurive shtetërore dhe përshejtimin e proceseve të likuidimit dhe çregjistrimit përfundimtar të shoqërive tregtare shtetërore.

Në pronësinë dhe përgjegjësinë administruese të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit ndodhen aktualisht disa shoqëri tregtare me kapital shtetëror mbi 51 për qind, të cilat ndodhen prej një periudhe shumëvjeçare në proces likuidimi dhe nuk ushtrojnë më veprimtari ekonomike. Këto shoqëri vijojnë të ekzistojnë si subjekte juridike kryesisht për qëllime të administrimit të aseteve dhe trajtimit të detyrimeve të mbartura ndër vite, ndërkohë që procesi i likuidimit nuk është përmbyllur ende. Situata aktuale karakterizohet nga detyrime të vjetra, një pjesë e të cilave rezultojnë të parashkruara ose të vështira për t'u verifikuar, si dhe nga pasuri të paluajtshme që kërkojnë inventarizim, regjistrim dhe administrim të mëtejshëm, çka e bën të nevojshme ndërhyrjen ligjore për përfundimin e rregullt të këtyre proceseve.

Shoqëritë tregtare që vijojnë të jenë në proces likuidimi përfshijnë, ndër të tjera, “Albbakër” sh.a., “Albkrom” sh.a., “Albminiera” sh.a., “Prodhim Mobilje” sh.a., “Petrol Alba” sh.a., “Duhan–Cigare” sh.a., “Albkontroll” sh.a. (Durrës), “Superfosfat Kurbin” sh.a dhe “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve”. Një pjesë e këtyre shoqërive kanë kaluar në likuidim që prej fillimit të viteve 2000, duke e zgjatur procesin e likuidimit për më shumë se 15–20 vjet, pa arritur mbylljen përfundimtare juridike dhe çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Analiza e situatës faktike dhe financiare të këtyre shoqërive evidenton problematika të përsëritura dhe strukturore. Detyrimet e mbartura prej tyre janë kryesisht detyrime shumë të vjetra, të krijuara në periudha të hershme, ku një pjesë e konsiderueshme rezultojnë të parashkruara, të pajustificuara ose të regjistruara gabimisht në kontabilitet, pa dokumentacion mbështetës ose ndaj subjekteve që nuk ekzistojnë më juridikisht. Në disa raste, këto detyrime përbëjnë pjesën dërmuese të borxhit të raportuar dhe nuk përfaqësojnë detyrime reale financiare.

Nga ana tjetër, këto shoqëri administrojnë një portofol të konsiderueshëm pasurish, kryesisht pasuri të paluajtshme, si truall, ndërtesa industriale, fabrika, depo, objekte teknike dhe galeri minerare, të shpërndara në disa rrethe të vendit. Vlera kontabël e aseteve tejkalon ndjeshëm vlerën e detyrimeve reale të pagueshme, duke krijuar potencial të mjaftueshëm për shlyerjen e këtyre detyrimeve, nëse aseteve do t'u jepej mundësia të administroheshin dhe të disponoheshin në mënyrë të unifikuar dhe efektive.

Megjithatë, procesi i likuidimit është penguar ndjeshëm nga mungesa e regjistrimit pronësor të një pjese të aseteve në regjistrat kadastralë, nga paqartësitë mbi titujt e pronësisë. Këto rrethana kanë pamundësuar shitjen, privatizimin ose dhënien në përdorim të pasurive dhe, për rrjedhojë, kanë bllokuar shlyerjen e detyrimeve dhe mbylljen përfundimtare të shoqërive.

Në këtë kontekst, ndërhyrja ligjore përmes projektligjit “Për mbylljen e shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim” paraqitet e domosdoshme dhe proporcionale, pasi vendos një regjim të posaçëm nga procedurat e përgjithshme të likuidimit, me qëllim:

- inventarizimin dhe klasifikimin ligjor të detyrimeve reale, të parashkuara dhe të pajustificuara;
- shlyerjen e detyrimeve reale sipas rendit të përparësisë të përcaktuar në Kodin Civil;
- fshirjen ligjore të borxheve historike të parashkuara;
- administrimin dhe disponimin e aseteve përmes një subjekti shtetëror pasues;
- mbylljen përfundimtare dhe çregjistrimin e shoqërive tregtare nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Efektet e pritshme nga zbatimi i projektligjit konsistojnë në rritjen e sigurisë juridike, racionalizimin e administrimit të pasurive shtetërore, reduktimin e subjekteve tregtare jofunksionale në pronësi publike, si dhe përmbylljen përfundimtare të proceseve të likuidimit të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, në përputhje me interesin publik dhe parimet e menaxhimit të mirë të pasurisë shtetërore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektligji është hartuar në përputhje me nenet 78, 81 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji vendos një regjim të posaçëm ligjor, i cili zbatohet në mënyrë përjashtuese nga procedurat e përgjithshme të likuidimit të parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, për shoqëritë tregtare me kapital shtetëror që ndodhen në proces likuidimi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për shkak të veçantisë së statusit të tyre dhe interesit publik që lidhet me administrimin e pasurive dhe detyrimeve shtetërore.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji nuk synon përafrimin e drejtpërdrejtë me acquis communautaire të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Projektligji përbëhet nga 11 nene dhe rregullon aspektet kryesore si vijon:

- **Neni 1** përcakton qëllimin e ligjit, i cili konsiston në mbylljen dhe çregjistrimin përfundimtar të shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim, si dhe në përcaktimin e mekanizmit për trajtimin, administrimin dhe kalimin e aseteve dhe detyrimeve të tyre.
- **Neni 2** përcakton fushën e zbatimit të ligjit, duke identifikuar shoqëritë tregtare me kapital shtetëror mbi 51 për qind që ndodhen në proces likuidimi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, si dhe parashikon vijimin e procedurave të likuidimit sipas ligjit nr.

9901, datë 14.4.2008, për shoqëritë që shpallen në likuidim pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

- **Neni 3** rregullon procedurën e mbylljes së shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim, duke parashikuar vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme, transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të shoqëria shtetërore pasuese, si dhe vendimin për prishjen, mbylljen përfundimtare dhe çregjistrimin e shoqërive në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- **Neni 4** rregullon inventarizimin dhe vlerësimin ekonomiko-financiar dhe pasuror të shoqërive tregtare shtetërore në likuidim, duke përcaktuar elementet përbërëse të raportit përfundimtar të mbylljes dhe trajtimin kontabël të detyrimeve debitoare dhe kreditore të parashkuara ose të pakërkueshme.
- **Neni 5** rregullon procedurën e çregjistrimit të shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe dokumentacionin që depozitohet për këtë qëllim.
- **Neni 6** parashikon krijimin e shoqërisë tregtare shtetërore pasuese “Operatori i Shoqërive Shtetërore” sh.a., duke përcaktuar statusin e saj juridik, aksionarin e vetëm, objektin e veprimtarisë, si dhe vazhdimësinë juridike në marrëdhëniet me palët e treta. Mënyra e financimit dhe administrimit të kapitalit fillestar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- **Neni 7** përcakton kapitalin fillestar të shoqërisë shtetërore pasuese, burimin e financimit, si dhe parashikon procedurën për ndryshimet e mëvonshme të kapitalit.
- **Neni 8** rregullon mbikëqyrjen e shoqërisë shtetërore pasuese nga ministria përgjegjëse për ekonominë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- **Neni 9** rregullon efektet juridike të mbylljes së shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim mbi likuidatorët dhe organet drejtuese ekzistuese, duke parashikuar përfundimin automatik të kompetencave të tyre dhe vlefshmërinë e veprimeve të kryera deri në hyrjen në fuqi të ligjit.
- **Neni 10** parashikon procedurën e dorëzimit të dokumentacionit administrativ, financiar, ligjor dhe teknik, nga shoqëritë tregtare me kapital shtetëror në likuidim të shoqëria e re e krijuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- **Neni 11** autorizon Këshillin e Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.
- **Neni 12** përcakton hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Këshilli i Ministrave; ministria përgjegjëse për ekonominë; shoqëria tregtare shtetërore e krijuar me këtë ligj, shoqëritë shtetërore në likuidim si dhe organet e tjera publike kompetente sipas fushës së përgjegjësisë.

VIII. VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.

Për qëllime të procesit të konsultimit dhe rakordimit ndërinstitucional, projektligji do t'u dërgohet për mendim ministrive të linjës, me qëllim verifikimin dhe identifikimin e shoqërive tregtare me kapital shtetëror që ndodhen në proces likuidimi dhe që mund të përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, si më poshtë:

- Ministrisë së Drejtësisë për vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të dispozitave të këtij projektligji;
- Ministrisë së Financave për vlerësimin e efekteve financiare dhe buxhetore që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji;
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Ministrisë së Mbrojtjes;
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
- Ministrisë së Mjedisit;
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon efekte financiare mbi buxhetin e shtetit, pasi themelimi i shoqërisë tregtare shtetërore pasuese parashikon mbulimin e kapitalit fillestar nga buxheti i shtetit. Shuma e kapitalit fillestar, mënyra e financimit dhe administrimit të tij do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike.